



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës - Gjakovë
01.Nr. 463/02-33035 /2018
Dt. 04.12.2018

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 10 paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, në mbledhjen e mbajtur me dt.04.12.2018, pas diskutimeve lidhur më pikën e 7-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesave për dhënien në shfrytëzim të pronës së Paluajtshme Komunale KEDS-it për vendosjen e 3 Trafostacioneve në Fshatin Doblbare dhe 1 në fshatin Marmull, e miratoi këtë:

V e n d i m
Për dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim

1. Aprovohet kërkesa e KEDS-it për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale në kohëzgjatje prej 99 vite pa kompensim material, në pjesën e ngastrës kadastrale me numër 1013- 4, ZK Marmull, P.SH. Pasuri e Fshatit, për vendosjen e Trafostacionit të tipit "Shtyllë", me dimensione (2.0 x 2.0) m², me sipërfaqe prej S= 4.0 m².
2. Autorizohen organet e administratës komunale që të ndjekin procedurat ligjore për dhënien në shfrytëzim KEDS-it, pronën Komunale të theksuar në pikën e 1-rë të këtij Vendimi.
3. Komuna në çdo kohë mund ta kthej në gjendjen e mëparshme pronën e cekur në pikën e 1-rë të këtij Vendimi, në rastet e shpalljes së interesit të përgjithshëm për realizimin e Planeve Rregulluese Urbane dhe Projekteve Komunale që janë në interes të qytetarëve.
4. Në obligimet e KEDS të parashihet gjithsesi investimi edhe në rehabilitimin e rrjetit në vendbanimin (lagjen) ku i është dhënë prona komunale në shfrytëzim për vendosjen e TS-it.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës .
6. **Vendimi iu dërgohet:**
 - Z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës.
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .
 - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit,

